



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/32

Datë: 17.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 maj 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej dhjetë milion e nëntëqind mijë euro (10,900,000.00 €), me qëllim të zbatimit të Pakos Emergjente Fiskale të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 01/19, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 06/25 të datës 17 prill 2020.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Kontigjenca në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, me kod 28900 dhe atë nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime shuma prej tetë milion e nëntëqind mijë euro (8,900,000.00 €) dhe nga kategoria e subvencioneve dhe transfere shuma prej dy milion euro (2,000,000.00 €).
3. Mjetet nga pika 1. i këtij Vendimi në shumë prej nëntë milion e katërqind mijë euro (9,400,000.00 €) euro transferohen në Ministrinë e Ekonomisë, Punësimi, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike me kod 204, në nën programin Ndërmarrësi me kod 49400 dhe atë në kategorinë ekonomike subvencionet dhe transferet shuma prej tetë milion e dyqindeshtatëdhjetëdy mijë e tetëqind euro (8,272,800.00 €); dhe në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej një milion dhe njëqindnjëzeteshtatë mijë e dyqind euro (1,127,200.00 €)
4. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi në shumën prej një milion e pesëqind mijë euro (1,500,000.00 €) euro transferohen në Ministrinë e Financave dhe Transfereve me kod 201 në nën programin Ndihmat Sociale me kod 00500 në kategorinë ekonomike subvencioneve dhe transfereve.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve strategjike për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**



---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë